



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 033
Prishtinë, më 30 korrik 2008, në orën 16:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 30 KORRIK 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai propozoi së pika e dytë, e paraparë për këtë seancë - Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës së mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, të shtyhet për seancën e radhës, me arsyetimin se ministri i Shërbimeve Publike, për shkaqe objektive nuk ishte i pranishëm në seancë.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ngarkuar me vendim të Kuvendit, si komision funksional, për ta shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit të vendit për vitin 2008, e ka shqyrtuar atë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Ai ftoi kryetarin e Komisioni për Buxhet dhe Financa, ta paraqesë Raportin para deputetëve.

Gani Koci, kryetar i Komisioni për Buxhet dhe Financa, tha se Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin me kujdes dhe të gjitha kërkesat e agjencive buxhetore, dhe njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime, i cili u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ai i propozoi Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2008, me rekomandimet e komisionit funksional.

Pasi që nuk pati të paraqitur për debat, Kryetari procedoi me votimin e amendamenteve, të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Në fund, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin së bashku me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----11,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale